

Njoftim për konsultimin publik të Raportimit Kombëtar Vullnetar të Shqipërisë (RKV/VNR) për Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ)

Mbi dokumentin e RKV/VNR:

(Draft) Raportimi Kombëtar Vullnetar i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (RKV/VNR) do të paraqitet në Forumin e Nivelit të Lartë Politik, i cili do të zhvillohet në korrik 2018, në selinë qendrore të Kombeve të Bashkuara, në New York. Ai konsiderohet një dokument i rëndësishëm në kuadër të raportimit mbi zbatimin e Axhendës për zhvillim të qendrueshëm dhe arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qendrueshëm të Kombeve të Bashkuara, ku Shqipëria së bashku me 46 vende anëtare të OKB-së do të paraqesin raportimet e tyre vullnetare kombëtare në Forumin e vitit 2018.

(Draft) RKV/VNR është përgatitur me kontributin e ministrive dhe institucioneve nëpërmjet një procesi bashkëveprimi dhe ndërveprimi, që synon gjithashtu të jetë sa më gjithëpërfshirës, pasi zbatimi i Axhendës për zhvillim të qendrueshëm dhe arritja e OZHQ-ve konsiderohet si një proces i gjatë, kompleks, transformues dhe gjithëpërfshirës.

Qëllimi i procesit të konsultimit:

Mbledhja e rekomandimeve dhe komenteve nga qytetarët, publiku i gjerë, shoqëria civile, akademikët, biznesi, partnerët për zhvillim, do të ndihmojë në përmirësimin dhe pasurimin e mëtejshëm të këtij dokumenti.

Ju ftojmë të dërgoni komentet dhe rekomandimet Tuaja, në adresën: skzhi@kryeministria.al